

KOQIJA

Ballina: Arziana Demiri

A ishte Stresi
më i merituari

Kah
është Kibla
për shqiptarë

Ku i pata
mendtë
që kam fëmijë
me tri gra

Në Kosovë
si në kohën
e Nastradinit

Cilët
këngëtarë tanë
kanë pasur
probleme
me ankth

Edhe duhen,
edhe ndahen

Kush është
anëtari më i ri
i UB-së

**ARZIANA
DEMIRI**

*zonja e çmuar
e fushës së estetikës*

remos

DENTFIX

SHERWOOD

**S
O
L
O
S**

BREZOVICA

allüre

UB
UNION BUSINESS

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

MOLLA

Shkenderi Dëshmor

Banaderm

MARITIM

CIMA

**TANI MUND TË BËNI
POROSI EDHE PËRMES
WEB APLIKACIONIT TONË TË RI:**

WWW.DINOQERAMIKA.STORE



Në ballinë



**ARZIANA
DEMIRI**

zonja
e çmuar
e fushës
së estetikës

Në ballinë

Emri i saj është i veçantë, po aq sa karakteri që ka dhe puna që bën. Ata që e njohin Arziana Demirin flasin fjalë të mëdha për të, për gruan dhe profesionisten e jashtëzakonshme.

E specializuar për estetikë, Arziana është një nga shqiptaret më të njohura të kësaj fushe. Zonja elegante, fine dhe me stil, sapo ka hapur sallonin e ri të kozmetikës në Oerlikon të Cyrihut, ku ishin të pranishëm shumë mysafirë e klientë. Se Arziana e ka gjetur formulën dhe e ka vulën e suksesit, kjo tashmë dihet.

Flasim me të, në cilësinë e imazhit të “Kosovares”...

Arzianë, jemi kureshtarë të dimë më shumë për ju?

- Jam Arziana Demiri, e lindur në Tetovë. Jetoj që nga viti 1981 në Zvicër. Jam e martuar dhe i kam tre fëmijë, një vajzë dhe dy djem. Punoj që nga viti 2020 estetiste, bashkë me burrin, i cili është mjek i përgjithshëm dhe ortoped. Më parë kam punuar në ordinancën e burrit tim - estetiste në Oerlikon të Cyrihut. Por, nga data 6. 2. 23 kam dalë në Kosmetiksallonin e ri, që gjendet, po ashtu, në Oerlikon, në të njëjtën rrugë ku është edhe ordinanca e burrit. Hapja e sallanit të ri është bërë më 4. 2. 23, ku kanë qenë shumë mysafirë të



rëndësishëm. Siç thuhet, ishte “krem de la kremi” i shqiptarëve të Cyrihut. Po ashtu, edhe Genta Ismajli dhe Usta na nderuan me pjesëmarrjen.

E, këtë emër të veçantë kush ta ka lënë?

- Emrin ma ka lënë halla ime. Kuptimi ka të bëjë me diç të artë...

Si e kujton fëmijërinë?

- Fëmijërinë e kam pasur shumë të lumtur. Kam pasur fatin të jem rritur në një gji familjar shumë të shëndoshë.

Si ishte adoleshenca jote?

- Adoleshencën e kam kaluar në Zvicër, në një shoqëri tejet të strukturuar dhe thuajse në çdo detaj të planifikuar. Kisha fatin që krahas shkollimit profesional, njëkohësisht, edhe të punoja. Kjo më jepte pavarësinë ekonomike edhe, kështu, kisha mundësi disa vendime të rëndësishme në jetë t'i sillja pa influencën e njerëzve të tjerë.

Kur dhe si vendose të aftësoheshe profesionalisht në fushën e estetikës?

- Vendimi ka qenë spontan, gradual dhe i mirëpritur. Pata fatin që, duke

punuar bashkë me burrin tim, i cili është mjek, gjeta pasionin tim që njerëzit t'i bëja më të lumtur, duke ua zbukuruar aparencën, anën estetike të tyre.

E, shumicës së njerëzve u ndihmon edhe në anën shpirtërore.

Mund të na flasësh më shumë për Qendrën tënde të estetikës “Arziana Kosmetik”?

- Salloni im estetik gjendet afër stacionit të trenit në Oerlikon të Cyrihut, që është një nga qendrat më të frekuentuara.

Emri i sallanit është “Arziana Kosmetik” dhe ofron një gamë të gjerë të shërbimeve estetike.



Cilat janë shërbimet?

- Depilim me laser medicinal
- PRP/Vampirlifting
- PRP kundër rënies së flokëve
- Mesotherapie
- Meso-Hair
- Aquapeeling, pastrim i thellë i lëkurës
- TCA Peelig
- Carbon Peeling / Hollywood Peelig
- Microneedling
- Lash & Browlifting
- Largim i tatove
- Largim i Microblading / Powder Brows
- Intim bleaching dhe bleaching i nënsqetullave
- EMP Shaper për rritjen e muskujve dhe shkrirjen e dhjamit
- Lymphdrainage / masazhi limfatik ndihmon humbjen e peshës, kundër celulitit, kundër edemës, kundër dhimbjeve lumbale, ndihmon për një metabolizëm të rregullt.

Diçka që bëni ndryshe ose më shumë se qendrat tjera të estetikës?

- Ne i përkushtohemi individualisht çdo klienti dhe nuk bëjmë trajtim serik. Por, meqë bashkëshorti im është mjek, bëjmë edhe trajtime medicinale.

Arzianë, si është të jesh grua, nënë, bashkëshorte dhe të jesh në biznes?

- Nuk është e lehtë, sepse kërkohet angazhim i përsosur profesional, e femra ka edhe obligime familjare. Por, punën estetiste e bëj me shumë përkushtim dhe entuziazëm.

A bëhet më sfiduese kur je larg vendlindjes?

- Kur je larg vendlindjes angazhimi është edhe një herë më i madh dhe më sfidues, sepse ndeshesh me mentalitete, botëkuptime dhe tradita të ndryshme, gjë që shprehet edhe në dëshirat individuale se si ata e perceptojnë të dukesh bukur pas një trajtimi estetik.

Çfarë do t'u thoshe grave të cilat kanë ëndrra, por jo edhe guxim?

- Ëndrrat jam të mira, por jo gjithmonë shumë afër realitetit. Është mirë që ëndrrën ta kthejnë në realitet.

Diçka që të bën të mos ndalesh?

- Dëshira e madhe për punë dhe profesion.

A do t'ia dilje pa mbështetjen e plotë të bashkëshortit?

- Unë dhe bashkëshorti im punojmë bashkë. Ai më mbështet në çdo pikëpamje të jetës që ndonjëherë është shumë sfiduese.

Arzianë, ke ndonjë hobi?

- Merrem me sport dhe, si shumica e femrave, bëj shopping.

A ke moto të jetës?

- Jetoje të tashmen!

Për fund?

- Fund nuk ka, sepse besoj në fizikën kuantike.

Ju faleminderit për bisedë!

- Faleminderit juve!

Nderim Neziri





Dy vjetëve të fundit u mbyllën 47 shkolla në Kosovë!

Në Shkollën fillore “Pjetër Bogdani” në Prishtinë vetëm dy vjetëve të fundit e braktisën shkollën 60 nxënës ose dy klasë më pak! Po, në shkollat tjera?

Se ikja e të rinjve, nxënësve dhe e profesionistëve nga Kosova është shumë aktuale, tregojnë edhe shifrat e nxënësve

që e kanë braktisur mësimin. Kështu, vetëm në Shkollën fillore “Pjetër Bogdani” në Prishtinë, shkollë e cila ndodhet në pjesën e qytetit të vjetër, dy vjetëve të fundit e braktisën mësimin 60 nxënës ose dy klasë më pak.

E, situata bëhet edhe më alarmante kur shihen shifrat në nivel vendi, të cilat tregojnë se vetëm dy vjetëve të fundit në arsimin parauniversitar të Kosovës janë mbi 16 mijë nxënës më pak, pra 47 shkolla të mbyllura!

E, kjo, jo vetëm që shkon në dëm të nxënësve, por edhe të arsimtarëve, sepse, nëse vazhdohet me këtë trend

të ikjes, së shpejti shumica e arsimtarëve do të mbesin pa punë. Sidoqoftë, çdo ditë, duke mos parë perspektivë në Kosovë, të rinj të talentuar e me potencial të jashtëzakonshëm po e braktisin vendin! Çdo ditë mjekë, motra mjekësore dhe profesionistë të tjerë po e braktisin vendin e punës dhe po ia mësyjnë Perëndimit, sepse perspektiva për një të ardhme në Kosovë sa vjen e zbehet! E, deri kur do të vazhdojë kështu, një Zot e di!

Megjithatë, thënë figurativisht, nuk shihet dritë as në fund të tunelit...

Selim Rama

PSE JETOJMË ME ËNDRRA?



“Njeriu që e shkon kohën me ëndrra të pëlqyera ka frikë të zgjohet. Po, le të marrë fund gjumi dhe menjëherë e sheh veten të rrethuar me gjëra të shëmtuara. Ta do zemra të futesh përsëri në gjumë e të kthehesh në botën e lulëzuar nga e cila sapo dole, po kot. Një ëndërr e zhdukur nuk përsëritet”.

Janë këto fjalë të të madhit Konicë, të thëna para shumë e shumë vitesh, por ngjajnë sikur i ka shkruar sot.

Dhe, sot, njeriu ynë, po qe se sheh ndonjë ëndërr të bukur, s’do të dëshironte të zgjohej fare.

Do të donte, madje, të jetonte në ëndërr. Të ëndërrojë se po jetonte pa probleme në Kosovën e lirë...

Të jetojë në vendin e lulëzuar pa dallavere që të ngulfatin shpirtin...

SOT

Filozofi i njohur, Xhon Raskini, ka pasur në tavolinën e tij të punës një gur të zakonshëm, por në të cilin ishte gdhendur fjala – SOT.

Ndërsa, poeti V. Osler i ka mbajtur gjithnjë në tavolinën e tij të punës këto vargje, të cilat dhe doemos i kanë rënë në sy e i ka lexuar përditë:

“Nëse sot kemi jetuar mirë
Dita e djeshme do të na duket
Si një ëndërr e bukur
Dhe çdo ditë e nesërme
Si vizion i shpresave
Ju thërras që ditën e sotme ta jetojmë”.

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Edona Vllasaliu - Bajoku
Natyra Salihaj

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



Bajrush Limani
në kohën kur e bëmë bisedën



Kush ishte Bajrush Limani që me sëpatë theu dyert e komunës së Lipjanit?

I këndohet kënga për të bërat e tij në mbrojtje të popullit të vet dhe të të varfërve. Bajrush Limani, i lindur më 6 prill 1922, në fshatin Gadime e Epërme të Lipjanit, nuk është bërë temë vetëm e këngëtarëve dhe folkloristëve aktualë që ka Kosova, por ai ka qenë temë frymëzimi edhe për shumë politikanë kosovarë të motivuar për patriotizëm.

Për patriotin Bajrush Limani nuk është shkruar edhe aq shumë, por shërben si shembull për të gjithë brezat e politikës institucionale dhe më gjerë, që të krijojnë motivin e luftës së avancimit të kombit nëpërmjet rrugëve legjitime që bën një popull me identitet dhe dinjitetshëm. Bajrush Limani është ndër të vetmit zyrtar institucional që ka punuar në kushte tepër të rënda, i rrethuar nga serbët e Lipjanit dhe më gjerë deri në Beograd, për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës, duke mos lejuar nëpërkëmbjen e dinjitetit shqiptar. Duke mbrojtur dinjitetin, ai ka mbrojtur me fakte e guxim kombin, duke lënë shembuj të panumërt si luftohet për

popullin e vet, duke luftuar padrejtësitë në ish-Jugosllavi.

Njeriu për të cilin nuk mund të thuhet gjithçka me një shkrim, Bajrush Limani është përfaqësuesi më dinjitoz i historisë së vështirë shqiptare në Kosovë, që ka lënë pas kapital intelektual patriotik për hulumtim të së vërtetës së thellë dhe mund t'i shërbejë aq shumë shembullit tipik si luftohet për popull për të mbrojtur krenarinë kombëtare, për të cilën ai e pat tepër të vështirë të luftojë i vetëm. Për këtë qëllim, ai krijoi shumë skena trishtuese për serbët që kishin pushtuar e okupuar komunën e Lipjanit dhe që kishin prejardhje çetnike dhe i urrenin me shpirt shqiptarët me të cilët edhe jetonin. Secila prej etapave të luftës së Bajrush Limanit për të drejtat shqiptare, përfaqëson popullin dhe kombin dhe është mundësi për qasje në libra të tërë, si pasqyrim kohe...

I shkolluar gjatë jetës për drejtësi në Zagreb, Bajrush Limani është patrioti i vetëm që nuk i lejoi serbët të bënin çka të donin në Lipjan dhe që mbrojtë demonstratat për Flamur e Republikë më 1968.

Ai sfidoi me shumë guxim tërë nomenklaturën çetnike serbe në Kosovën qendrore, e cila ishte përqendruar në krijimin e rendit politiko-ekonomik lokal e më gjerë në nivel të Kosovës.

Bajrush Limani u shërbeu atëherë, por u shërben edhe tash, politikanëve kosovarë për qëllime të fushatës, duke përmendur shembullin e tij se si duhet mbrojtur kombi.

ÇKA E BËRI TË MADH BAJRUSH LIMANIN?

Bajrush Limani u lind më 6 prill 1922, në fshatin Gadime e Epërme të Lipjanit. Aty e kreu shkollën e ulët prej katër vitesh dhe u bë njeriu më i arsimuar në lokalitet. Kishte shkruar ushtar në Zagreb dhe atje përfaqësoi njeriun e shkolluar kosovar-shqiptar, por në ushtri e kishin quajtur Limanoviq.

Ai e zotëronte mirë serbishten, si gjuhë komunikimi, sepse shkollimin e ulët e kishte bërë në serbisht.

Djali i Bajrushit, Hanefiu, në kohën kur e zhvilluam bisedën, 73 vjeç, i ka pohuar revistës sonë se babai i tij i kishte treguar se në shërbimin ushtarak në Zagreb ishte shembull i jashtëzakonshëm i kulturës së punës administrative, meqë posedonte dije të mjaftueshme nga puna e zyrave.

Dhe, duke treguar për detajet e tjera të babait të vet, Hanefiu, thotë:

"Në Zagreb ushtarët shqiptarë ishin shumë me numër. Kur e kishte kryer ushtrinë, oficerët e lartë ushtarakë, e kishin graduar për kontributin e tij në ushtri. I kishin hapur rrugën të kërkonte çfarë të donte. Në mesin e asaj oferte ishte edhe mundësia e shërbimit të tij në ushtri.

Por, ajo që e kishte kërkuar veçmas ishte një makinë shkrimi, me të cilën kishte arritur të daktilografonte mirë.

Dhe, makinën e shkrimit ia kishin dhënë ta merrte me vete në shtëpi...

Në vitin 1946 ishte punësuar në komu-

nën e asaj kohe, e që funksiononte në Babushin e Muhaxherëve, komunë që ishte nën ndikimin e serbo-malazezëve të fshatit, të dominuar nga Vujoviqët. Aty kishte punuar deri në vitin 1949, për ta larguar më pas nga puna, shkaku i lidhjeve familjare të tij me familjet balliste të Qerim Leskocit dhe Ahmet Bytyçit nga fshati Mirash i komunës së Ferizajt. Ishte bërë halë në sytë e serbëve të komunës së Babushit, të cilët e kishin hulumtuar në pikëpamje ideologjike lidhjen familjare të Bajrush Limanit, për të gjetur një arsye të largimit nga puna. Si shqiptar i vetëm i shkolluar në lokalitetin e tij të lindjes, kishte lënë vakuum të madh institucional aty, pasi që shumica absolute e popullatës ishin shqiptarë. Kishin kërkuar dikë tjetër, por nuk kishin gjetur një të tillë për të zëvendësuar Bajrushin, andaj e kishin kthyer në punë gjashtë muaj më vonë”.

SI IU NDALUA BAJRUSH LIMANIT SËRISH HYRJA NË KOMUNËN E LIPJANIT?

Duke treguar tutje për sfidat e jetës së babait, Hanefiu, thotë: “Zyrtarët serbë të komunës së Lipjanit në atë kohë ishin munduar të gjenin argumente se si ta largonin tim et nga komuna, meqë në atë kohë komuna ishte zhvendosur nga Babushi i Muhaxherëve në Lipjan. Si pretekst të largimit të tij nga puna këtë herë gjejnë pretekstin kinse Bajrush kishte harxhuar shumë buxhet komunal për shërimin e shqiptarëve të sëmurë dhe, sipas serbëve komunalë, ai rrezikonte ta linte komunën pa buxhet! Dhe, Bajrushit i ndalohej hyrja në objektin komunal, pa paralajmërim. E, në momentin kur ishte në derë të komunës roja e komunës, Smajl Gashi, i kishte dal para dhe i kishte thënë: “Bajrush, kam urdhër nga kryetari i komunës të të mos lejoj të hysh në komunë!”. Bajrush nuk ishte shtyrë me Smajlin, meqë e dinte se ai nuk kishte faj, por i kishte thënë - ti po e zbaton urdhrin dhe asgjë më shumë... Ishte kthyer prapa, por, meqë e njihte mirë objektin e komunës, ishte futur brenda nëpër bodrum, e kishte marrë sëpatën dhe ishte nisur drejt korridorit të komunës. Kryetari i komunës, bashkë me stafin që kishin dhënë urdhër të mos hynte Bajrush në komunë, kur e shohin me sëpatë në dorë, ikin nëpërmjet dritareve, kurse Bajrush kishte hyrë në zyrën e vet. E kishte marrë makinën e shkrimit, e që e kishte dhuratë nga komanda ushtarake e Zagrebit, por edhe dokumentacionin e vet dhe ia mësynë derës kryesore të komunës,

duke i kërkuar në zyrat e tyre dy serbët kryesorë të udhëheqjes komunale, Llazar Vujoviqin dhe Gaja Vujoviqin, si dhe një shqiptar që bashkëpunonte me ta, por që kishin ikur nga zyrat e tyre më parë, meqë roja e komunës i kishte paralajmëruar se Bajrush i kishte marrë sëpatën. Dhe, me po atë sëpatë ai, pastaj, i kishte thyer dyert e komunës”.

TAKIMI I BAJRUSHIT ME RANKOVIQIN

“Tre vjet kishte zgjatur gjykimi i Bajrush Limanit për sulm me sëpatë në komunën e Lipjanit dhe për rrezikim të jetës së parisë së saj.

Roja e komunës, Smajl Gashi, në gjyq nuk kishte pranuar të thoshte se Bajrush Limani ka përdor sëpatën për t’i thyer dyert e komunës, por kishte thënë se i ka thyer me shqelma.

Në gjyq kishin marrë pjesë katër vetë, si dhe Fadil Hoxha, për të kundërshtuar Bajrush Limanin, por nuk kishin mundur ta thyenin atë.

I vendosur të kthehej në punë për ta ndihmuar popullatën, e cila aso kohe ishte në varfëri të plotë, Bajrush kishte marrë rrugën për në Beograd, që të takohej personalisht me Josip Broz Titon. Ishte lajmëruar te sekretarja e tij dhe, pasi ishte protokolluar kërkesa, kishte pritur tri ditë ta takonte Titon.

Por, meqë ai kishte qenë i zënë, Bajrushin e kishin urdhëruar të takohej me Aleksandër Rankoviqin. Dhe, Rankoviqi, antishqiptari më i përbetuar, e kishte pranuar Bajrush Limanin në zyrën e tij.

“Unë jam Limanoviqi”, ishte prezantuar Bajrush Limani.

Rankoviqi kishte menduar se fjala është pasur durim ta dëgjonte Bajrushin për të gjitha padrejtësitë që i ishin bërë nga klasa politike e kohës.

Rankoviqi shkruan diç në letër dhe e mbyllë zarfin. Pastaj, ia jep tri vula zarfit dhe i thotë t’ia japësh personalisht Fadil Hoxhës. Dhe, në të dalë nga zyra e Rankoviqit, i kishte thënë:

“Limanoviq, me ia dërguar personalisht letrën Fadil Hoxhës dhe me i thënë se unë të kam kthyer në punë. Dua që ty të të gjej të parin e komunës kur të vij atje, përndryshe s’kam për ta lënë të gjallë asnjë shqiptar atje!”.

Bajrush i kishte thënë: “Nëse je duke jetuar me këtë ide, të shfarosjes së shqiptarëve, ti ke me shkua para tyre, prandaj ndërroje kursin!”.

Me t’u kthyer nga Beogradi, me zarfin në dorë, kishte shkua te Fadil Hoxha dhe ia kishte dhënë zarfin.

Fadili e kishte kthyer menjëherë në komunë, madje si sekretar komune”, thotë Hanefiu.

MBËSHTETJA E DEMONSTRATAVE TË VITIT 1968

E, duke treguar, tutje, historikun e jetës dhe të punës së babait të vet, Bajrushit, i biri, Hanefiu, thotë:

“Në periudhën deri te viti 1968 Bajrush kishte kaluar nëpër dhjetëra probleme, përmes të cilave kishin synuar ta përmbysyn si kundërshtar të regjimit, por nuk kishin arritur.

Në vitin 1968 u bën demonstratat për Flamur. Babai më mori me vete dhe u nisëm për në Prishtinë, për të marrë pjesë në ato kërkesa që kishte populli.

Zbritëm në Prishtinë nga autobusi, por babai kishte vërejtur se e përcillnin njerëz të UDB-së dhe ndërroi kaun e ecjes...

Më dërgoi mua te mjeku, kinse kishim ardhur në Prishtinë për mjekim...

Pas një kontrolli formal që ma bëri një mjek, u nisëm në drejtim të stacionit të autobusëve, e që aso kohe ndodhej te vendi i quajtur “Plepat”, në afërsi të RTK-së së sotme.

Turma e demonstruesve ndodhej mu afër stacionit të autobusëve. Tre vetë u ndanë prej turmës e iu afruan babait, duke menduar se ai ishte serb, meqë kishte “kasketë” në kokë, i brohoritën: “Kosova-Republikë!”. Babai, me tërë fuqinë që kishte, u tha: “Kosova me Flamur! Kosova-Republikë!”.

KËRKESA QË TË PUNOJË NË PUNËT E BRENDSHME...

“Në vitin 1970 babait i erdhi një kërkesë direkte nga Xhevdet Hamza, që të punonte në shërbimin e punëve të brendshme.

Por, babai nuk e kishte pranuar”, shpallosë Hanefiu dhe shton:

“Babai u kishte thënë: “Nuk dua të punoj në atë vend, meqë jam i lidhur për popullin, e nuk dua të jem aty ku rrahet dru populli im!”.

Dhe, meqë babai e refuzon ofertën e Xhevdet Hamzës, e largojnë nga posti i sekretarit të komunës. E transferojnë në Magurë, si avokat, meqë ndërkohë kishte kryer shkollën për drejtësi në Zagreb. Nuk shkoi shumë kohë dhe babai u identifikua me sëmundjen e kancerit, ndërsa e ka ndihmuar në trajtim direkt i madhi dr. Ali Sokoli, me të cilin ka pasur raporte të veçanta të interesit kombëtar, për të cilat nuk jam i njoftuar sa duhet...

Babai ka vdekur në dhjetor të vitit 1974.

Sot jemi 37 anëtarë nga familja e babait, por kurrë nuk kemi mundur të gjejmë punë, pos vëllait, Mustafës, që ka kryer fakultetin dhe ka gjetur punë në fshatin Plitkoviq të Lipjanit, ku ndodhet edhe sot”.

S. Krivaça

Sa shqiptarë aq parti politike!

Një burrë me ngjyrë ngriti duart para qindra mijëra njerëzve, për të shprehur lid-ershipin e tij kundër racizmit në botë. Pamja e tij para turmës, pak vite më vonë, u bë një portret në skulpturë dhe sot e atë ditë qëndron aty simbol i vlerave të unitetit njerëzor në luftë kundër racizmit.



Ngjarja ka ndodhur në Afrikën e Jugut, kur Mandela, që kishte mbajtur burg më pak se Demaçi ynë, u ngrit në nivelin e simbolikës së zhdukjes së frikës te raca e zezë, e cila me shekuj frikësohej nga raca e bardhë elitare që gjithmonë ndodhej në pushtet. Afrika e Jugut, shtet me 43 milionë banorë, i kishte vetëm 12 për qind të popullatës me ngjyrë të bardhë, e cila zbatonte politikën e aparteidit kundrejt 88 për qind të popujve me ngjyrë!

Mandela në foltore u tha miliona njerëzve se të varfrit dhe të pasurit, të bardhët dhe të zinjët, të uriturit dhe të ngopurit, do të jenë të njëjtë para ligjit dhe në jetë.

Por, çka na duhet neve filozofia për Afrikën Jugore?

Përgjigja është e thjeshtë: Atje, ku shpesh tallemi me fjalët "si në Afrikë", është gjetur forcë të vihet në praktikën e republikës një unitet mes popujsh me shumë raca për ta varrosur racizmin.

E, te ne, në zemër të Evropës, në republikën tonë me jo më shumë se 1 milion e 700 mijë banorë, nuk po gjendet fuqi për bashkimin e njerëzve të një kombi!

Siç thotë një batutë: "Ku janë tre shq-

iptarë, janë katër parti politike!"

Kur thërriste Hashim Thaçi për unitet, askush s'i shkonte pas!

Thaçi kur u zgjodh president, i tha Kurtit:

"Eja të shkojmë bashkë në Uashington, ta nënshkruajmë dokumentin që po na afron Amerika dhe e heqim qafe një herë e përgjithmonë Serbinë!"

Por, Kurti e injoroi...

Sidoqoftë, te ne praktika ka dëshmuar se cilido kryeministër që ulet në kolltukun e postit të kryeministrit, bën ftesë që t'i bashkohen të tjerët, por kjo nuk ndodh asnjëherë.

Këta jemi ne, andaj nuk është e çuditshme që jemi rastësisht të fundit në Ballkan që po luftojmë ta bëjmë shtetin.

MOSBESIMI GJENETIK

Me mosbesim gjenetik, së fundi, u mor shkenca pas tërmetit të rëndë në Turqi. Atje u shfaqën drita në qiell, para se ta godiste tërmeti atë pjesë të Turqisë, që ndodhi muaj më parë. Njerëzit thanë se qielli ishte zditur nga drita të forta dhe për ta shpjeguar historinë e kësaj historie, shkencëtarët shkuan edhe më larg: Thanë se janë paraqitur deri në 1600 drita të ndryshme.

Shkencëtarët thanë se fenomeni i dritave të shfaqura nuk ka shpjegim akoma, por ajo që besohet është ana besëtytënore: Demek, para se të godet tërmeti, dritat paralajmërohen nga bota tjetër që është një aludim në kiametin sipas Kuranit, apo apokalipsin sipas Biblës.

Sillu e mbështillu, përsëri te besëtytënia! D.m.th., ashtu siç shpjegohen burimet e strategjisë dhe të zbulimit e kundërzbulimit të koncepteve moderne të doktrinës së luftërave bashkëkohore se për ta mposhtur kundërshtarin duhet t'i posedosh informacionet e bollshme për strukturën e arsenalit të tij dhe potencialin numerik ushtarak.

Në librin e Henri Kisingjerit "Diplomacia", shpjegohen fillet e para të strategjisë luftarake në Kinë, kur dy ushtri përballë njëra-tjetrës donin të dinin se çka posedonte kundërshtari nga armatimi dhe ushtarët. Meqë atëherë nuk kishte dron, as pamje satelitore prej nga do të verifikohej arsenalin e kundërshtarëve, pri-jësit e luftës konsultonin parashikuesit që njiheshin si bazë profetike e dijes. Strategët ushtarakë shkonin te parashikuesit dhe ai u tregonte se çka posedonte armiku. Pasi i merrnin

informacionet, ata prisnin fitoren në luftë.

Andaj, ku mungon shkenca, njeriu i kthehet besimit...

Sepse, nëse dikujt i bën mirë, të mirën ta kthen Zoti.

Kështu veproi një mysliman menjëherë pas tërmetit në Turqi, i cili 63 milionë dollarë amerikanë i dërgoi në ambasadën e Turqisë në SHBA për ndihmë njerëzve që kishin pësuar nga tërmeti.

Por, ai nuk e tregoi as emrin, sepse, tha, po e bënte për Zot e jo për mendjemadhësi.

E, këtë punën e besimit po e ndërlihi me qëllim për të treguar diçka interesante: Gjenetika, ne nuk i kemi besuar njëri-tjetrit. Një parti politike nuk i beson partisë tjetër. As një lider nuk i beson liderit tjetër.

E, koncepti i mospajtit tonë rrjedh nga zemra e kalbur, se shpirti nuk duron ta shoh dikë në pozitë të lartë, pavarësisht dijes që ka ai në kokë.

Sepse, nuk mbaj mend që ndaj një lideri në Kosovë nuk është shfaqur diçka e papranueshme dhe denigruese.

Safet Krivaça

Anekdote



Kah është Kibla për shqiptarët?

Në një odë në Dukagjin kishin biseduar partitë politike se qysh e kritikojnë njëra-tjetrën e po shkaktojnë pakënaqësi në popull.

Dhe, teksa e dëgjonte muhabetin një plak, u thotë:

"Ish kanë shku njani mysafir. Nuk e gjan aty t'zotin e shpisë, por një djalë t'ri. Dikur musafiri merr avdes e po e vetë djalin e shpisë se kah asht kibla se po du me u falë..."

E, kur i kallëzon djali, ai nis me e falë akshamin. Dhe, teksa ai falej, hin edhe një mysafir tjetër. Ai, edhe pse

e pa këtë t'u u falë, i drejtohet djalit se kah asht kibla se po du m'e falë akshamin edhe unë...

Djali ish kanë i mençëm dhe drejton n'anën tjetër.

Kur hi n'odë i zoti i shpisë e i shoh ata tu u falë në drejtime të kundërta, i thotë djalit: "Çka u ba kështu?!"

Djali i kallëzon babës qysh e kanë vetë e qysh u ka thanë ai.

Atëherë plaku i thotë të birit:

"Eh, more bir, na shqiptarët, për inati t'njani-tjetrit, kurrë nuk jemi rreshtu me një drejtim!"



Ali Podrimja:

***Unë, biri yt, Kosovë
t'i njoh dëshirat
e heshtura,
T'i njoh ëndrrat,
erërat e fjetura
me shekuj,
T'i njoh vuajtjet,
gëzimet, vdekjet...***



UB
UNION BUSINESS
 ALBANISCH & DEUTSCH

+49 211 88 250 220
 +49 152 24 756 280
 +383 48 735 734

www.union-business.de
 info@union-business.de

Unioni i Bizneseve me kompaninë "Oppenhoff" organizon trajnim në disa pika të ligjit ndërtimor...

Sekuenca nga trajnimi në fushën ndërtimore, të paluejtshmërive dhe mbrojtjes në punë.

Në Gjermani, ligji i ndërtimit dhe i pasurive të paluajtshme në vazhdimësi po pëson ndryshime shkak i krizave ndërkombëtare dhe standardeve mjedisore. Në Köln të Gjermanisë, është mbajtur një trajnim njëditor lidhur me ndryshimet në disa pika të ligjit ndërtimor, ligjit për paluajtshëmri, ligjit për mbrojtjen në punë në projekte ndërtimore.

Trajnim ky i organizuar për herë të parë i këtij lloji nga Unioni i Bizneseve shqiptare – gjermane në Gjermani, në bashkëpunim me kompaninë profesionale "Oppenhoff", me ekspert e avokat të mirënjohur, e cila kompani konsiderohet ndër lideret në Gjermani në fushën e shërbimeve juridike-ekonomike, pjesë e së cilës është edhe Avokati shqiptar me prejardhje nga Ulqini, Dr. Nefail Berjasevic, njëherit profesor universitar i të drejtës ekonomike në Universitetin Siegen, me një përvojë mbi 14 vjeçare në këtë Universitet.

Avokatët e respektuar të kësaj kompanie prezantuan për disa anëtar të Unionit

të Bizneseve, në mënyrë profesionale dhe me shembuj, ndryshimet ligjore për tendencat dhe zhvillimet më të fundit në fushat e kontrollit të çmimeve, rreziqeve të përgjegjësisë, projekteve të ndërtimit në falimentim dhe ESG.

Për kontrollin e çmimeve, se si ta mbrojmë kompaninë kundër rritjes së kostos gjatë projektit dhe si ta përgatisim më mirë kompaninë për vonesat me nënkontraktorët e të tjera, ka folur avokati i mirënjohur Marvin Rochner, Avokat, Partner Junior, Oppenhoff.

Kurse për rrezikun në ndërtim dhe përgjegjësisë, se si ta ndajmë fushën tonë të përgjegjësisë dhe përgjegjësisë nga ajo e akterëve të tjerë? Si të shmangim rreziqet e paparashikueshme të përgjegjësisë për kompaninë dhe menaxhmentin në rast dëmtimi?, kanë folur avokatët Jörn Kuhn, Avokat, Avokat Specialist për të Drejtën e Punës, Partner, Oppenhoff dhe Marvin Rochner, Avokat, Partner Junior, Oppenhoff.

Për projektet e ndërtimit në falimentim, se si mund të siguroj kompania me pretendimet kundër falimentimit të klientit? Cila është praktika më e mirë aktualisht në treg?, ka folur Marc Alexander Häger, LL.M., Avokat, Partner, Oppenhoff.

Dhe për ESG, se cila janë tendencat dhe perspektivat në negocimin dhe zbatimin e standardeve mjedisore në kontratat e pasurive të paluajtshme?, kanë folur avokatët Marc Alexander Häger, LL.M., Avokat, Partner, Oppenhoff dhe Marvin Rochner, Avokat, Partner Junior, Oppenhoff.

Unioni i bizneseve i është shumë falënderues, Dr Nefailit për përkrahjen e vazhdueshme që i jep Unionit të Bizneseve, jo vetëm në fushën e këshillimeve, por edhe në trajnime të llojeve të tilla.

Pjesëmarrësit e Unionit në këtë takim, kryesisht ishin nga fusha e ndërtimeve, paluajtshmërive, pika të cilat përkonin edhe me temat që u diskutuan në këtë trajnim.

Unioni i Bizneseve do të vazhdojë me trajnime të tilla edhe në vendet të tjera, ku pikënisje tjetër mendohet të jetë edhe një takim në Frankfurt, ku zyra e avokaturës Oppenhoff ka një gjithashtu edhe një seli të saj.

Trajnimet të tilla janë të mirëseardhura, ku prekun shumë tema që ballafaqohen afaristë shqiptar në Gjermani dhe në të ardhmen do të mbahen në fusha të ndryshme.



Kush është anëtar i ri

Premium të UB-së në Gjermani, Gazi Ademaj

Unioni i bizneseve ka kënaqësinë të prezantoi edhe njërin nga anëtarët ma te ri Premium të UB-së në Mynih të Gjermanisë, Gazi Ademaj, pronar i hotelit "Innspire", njëherit edhe pronar i Kompanisë AG "Bau GmbH", AG Hausverwaltung dhe Innspire Ristorante.

Hoteli Innspire, me pronar Gazi Ademaj, ndodhet në Mynih, 3.8 km nga Stacioni i Trenit në Mynih-Pasing, Innspire Hotel përmban akomodim me një sallë pritjeje të përbashkët, parking privat, një terracë dhe një restorant.

Ky hotel me 4 yje ofron shërbim në dhomë, ATM dhe WiFi falas. Akomodimi ofron transferta në aeroport, ndërsa ofrohet edhe shërbimi i marrjes me qira të makinave.

Poashtu Ademaj, në Gjermani ka edhe kompaninë Bau GmbH, kompani ndërtimi ku praktikojë mjeshtërinë gjermane me zemër dhe pasion e cila është part-

nere me shumë kompani të tjera të cilat veprojnë në Gjermani dhe bëjnë kryerjen e pavarur të punimeve nga kryepunëtorët me përvojë, muratorë, makineri, kantieri të ndërtimit, e të tjera.

Kompanitë e ndërtimit të Gazi Ademaj, ofrojnë ndërtim me çelësa në dorë, shitje-bleje të patundshmërive, administrim të objekteve, e të tjera.

Cilësia e shërbimit dhe kënaqësia e klientit janë prioritetet e tyre kryesore. Kompania Bau GmbH e Z. Ademaj, ka realizuar projekte shumë të suksesshme nga më të ndryshmet në ndërtimtari.



AG BAU
Planung / Ausführung / Generalunternehmer
Löhnerstr. 58
81243 München
Tel: +49 89 54 62 80 80
Email: info@agbau-muenchen.de



AG HAUSVERWALTUNG
Hausverwaltung / Immobilien der Eigentümer
Löhnerstr. 58
81243 München
Tel: +49 89 54 65 80 85
Email: Fu@agbau-muenchen.de



Innspire Hotel GmbH
Löhnerstr. 58
81243 München
Tel: +49 89 620 963 9
Email: info@innspire-hotels.de



Innspire Restaurants
Löhnerstr. 58
81243 München
Tel: +49 89 620 963 130
Email: info@innspire-restaurants.de



Projektgesellschaft Proden 24 GmbH
Projektentwicklung / Immobilienverkauf / Immobilienverwaltung
Schwarzenstr. 11
80338 München
Email: info@proden24.de

A duhet të shkoni në martesë e virgjër?

Në të shumtën e rasteve vajzat shqiptare humbjen e virgjërisë e marrin si kërkesë apo dëshirë e të dashurit të tyre, e jo si dëshirë edhe e tyre.

Kështu, meqë tema është shumë e ndjeshme për shoqërinë tonë, të anketuarat tona po i japim vetëm me emër...

ERMIRA, 22 VJEÇE, ABSOLVENTE NË UNIVERSITETIN E GJAKOVËS:

- Kur i dëgjojmë nënat tona duke folur për dashurinë e jetës së tyre, të jep të kuptosh se virgjëria në atë kohë ka qenë e paprekshme para martesës. Por, a duhet të jetë para dashurisë? Mendoj se jo.

Të dashurosh mendoj ta pranosh dikë ashtu si është: e virgjër apo me përvojë dashurie... Pra, për mua nuk është me rëndësi

virgjëria në dashuri, por ndjenja në dashuri.

Por, te shumica e njerëzve virgjëria është ende vendimtare në krijimin e një lidhjeje, e cila do të kurorëzohet me martesë.

Megjithatë, bëhen shumë mashtime si nga ana e djemve ashtu edhe të vajzave, pikërisht kur është fjala për këtë dukuri.

Shembull, disa djem thonë se nuk u intereson e kaluara e vajzës, pastaj kur të vjen koha të hedhet hapi i martesës ndryshojnë mendjen, ndërkohë disa vajza mundohen të shtirën si të virgjëra, kurse, në të vërtetë, nuk janë.

SYKALTRA, 24 VJEÇE, NGA PRISHTINA, PUNËTORE NË BUTIK:

- Ato vajza që ia falin virgjërinë të dashurit vetëm se frikësohen apo nga dhuna, nuk dinë se ç'është jeta, sepse nuk duhet të bëjnë asgjë nga presioni. Mua, shembull, askush nuk mund të ma ndryshojë qëndrimin tim, vendosmërinë time, sepse Zoti më ka krijuar të jem vajzë e vendosur në vendimet që marrë.

No seks para martesës dhe pikë, sepse personi që të do, pa fije dyshimi, do të të pres deri në martesë.

E, nëse nuk pajtohet, jepja plaçkat dhe mos u pendo hiq, sepse nuk është i duhuri yt.

Unë një të tilli do i thosha: Martohemi dhe jam e jote përgjithmonë! Mirë a keq?

VALERIANA, 25 VJEÇE, FIZIOTERAPEUTE:

- Të jesh 20 a 22 vjeçe dhe ta ruash virgjërinë për mua është në rregull. Por, nëse i ke kaluar të 30-at dhe ende e ruan virgjërinë, mendoj se kjo është e pakuptimtë, sepse trupi kërkon dashuri e dashuria mungon!

Në Angli, ku kam jetuar 10 vjet, femrat që duan të mbesin të virgjëra deri në martesë kanë shkaqe të forta psikologjike për të rezistuar kundër dashurisë trupore. Por, ato janë raste të rralla, të cilat psikologjikisht i konsiderojnë si femra me depresione të mëdha psikike.

Për fund

Disa janë të mendimit se virgjërinë duhet dhënë vetëm njeriut me të cilin martohen, kurse disa virgjërinë nuk e bëjnë problematike.

Pra, varet nga personi se si i shikon gjërat në jetë...

Diturie Haxhaj

S
O
L
O
S



“Solos Studio” zgjedhja e parë për ata që kërkojnë cilësi dhe veçanti për ambientet e tyre



*Solos Studio sjel-
lë veçanti dhe
frymon brenda
hapësirave të
ndryshme që
nga viti 2016.
Me stilin unik,
thjeshtësinë e
produkteve dhe
cilësinë supe-
riore, “Solos
Studio” tashmë
është zgjedhja
e secilit për t’i
dhuruar identitet
çdo ambienti.*

Showroom-i prezanton markat ndërkombëtare të ndriçimit dhe mobiljeve siç janë: Flos, Eichholts, Zuiver, Bonaldo, Flexlux, Ditre Italia, Villeroy & Boch, Dyson, Danform, Deekhoorn, Zambelis, Jati & Kebon, Richmond, Vibia, Fatboy, Foscari, Nude Glass, Emu chairs, Antares, Metsan, Profim, Tabanda, WMF dhe shumë brende të cilat krijojnë rehati për çdo hapësirë.

Produktet që gjenden në “Solos Studio” dhurojnë koncept të çdo brendi dhe emocion në çdo përjetim. Ato i takojnë krijimeve të cilësisë më të lartë dhe paraqesin koleksionet më të reja, teksa përfshijnë shumë-
lojshmëri formash, ngjyrash dhe kulturash nga e gjithë bota. Këto elemente bëjnë që çdo shtëpi dhe ambient të frymojë ndryshe.

Në “Solos Studio”, kanë krijuar mënyrat më të lehta të komunikimit, duke promovuar produktet e tyre në rrjetet sociale, si Facebook dhe Instagram, apo duke i vizituar në showroom-in në adresën : Magjistralja Prishtinë-Shkup, përballë “Hotel Emerald



Humanisti Halil Kastrati me një skamnor

Në Kosovë jetohet si në kohën e Nastradinit!

Nastradin Hoxha kishte pasur shumë dëshira, por dy më kryesoret ishin për të...

Nastradini i thotë gruas:

"Më sill djathë, grua, se djathi të shton kujtesën, mendjen dhe të rritë fuqinë!"

Gruaja u ngushtua, ngase nuk i kishte mbetur djathë në shtëpi.

"Nuk ka mbetur djathë, Nastradin aga".

"Mirë që nuk paska mbetur, sepse djathi t'i prishë dhëmbët, lukthin!"

Gruas i erdhi pakëz shpirti nga ajo që i tha Nastradini, por ai i kërkoi diç tjetër.

"Grua, më sill pekmez se ma shton oreksin, ma shton jetën dhe më jep energji!", i thotë ai.

Gruaja sërish u ngushtua, por s'pati qare pa i thënë se nuk kishte mbetur as pekmez...

Nastradini i thotë:

"Mirë që s'ka mbetur pekmez, sepse edhe ai t'i prishë dhëmbët, e rrit sheqerin në gjak!"

"Nastradin, merre këtë copë bukë dhe të bëftë mirë se nuk mbeti gjë tjetër

pos saj!", i thotë gruaja.

Nastradini ia kthen:

"Mirë që ka mbetur kjo copë bukë, bile, sepse kjo nuk është më punë dëshirash, por është punë barku! Pa të nuk bën. Të tjerat janë luks, grua!"

SI POPULL, CILAT DËSHIRA I KEMI?

Kështu, disi, ka mbetur edhe puna e dëshirave tona... Kemi shumë dëshira, por nuk kemi as bukë sa duam, sepse ka njerëz që nuk e sigurojnë as bukën. Për të qenë të bindur në këtë fakt, mund të shihni në mëngjes shumë njerëz teksa presin të marrin bukën e djeshme.

Furrтарët dhe ta pasurit e quajnë "bukë bajate", ndërsa skamnorët e quajnë "bukë ekzistence".

Kishte shkuar njëri te miku.

"A do tash bukë e kripë a më vonë bukë e mjaltë?", i thotë i zoti i shtëpisë.

Mysafiri ia kthen:

"Po pres më vonë bukë e mjaltë".

Pas disa orësh i zoti i shtëpisë i vuri në sofër bukë dhe kripë.

"Ku është mjalti, o mik?!", i thotë mysafiri.

I zoti i shtëpisë, duke ditur se mysafiri ishte uritur, i thotë:

"A nuk po të duket buka e shijshme si mjaltë, a?!".

BUKË ME MJALTË HANË VETËM POLITIKANËT DHE ATA QË MERREN ME TENDERË!

Prandaj, edhe te ne po ndodh diçka e ngjashme. Papunësia e madhe nuk ta mundëson të hash bukë me mjaltë. Bukë e mjaltë kanë vetëm njerëzit që merren me politikë, me hajni e tenderë...

S. Rama

OFERTA E MARSIT

Vlen nga e Diela deri të Premtën

Për të gjitha tipologjitë e dhomave

30%

ZBRITJE

Mëngjesi | SPA | Fitness

HOTEL BREZOVICA

Aquarius Spa Center

Qasja ditore për person

20€

ZBRITJE

10€ për fëmijët 6 - 12 vjeç

Pa pagesë për fëmijët 0 - 5 vjeç

★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA

Edhe duhen, edhe ndahen!

Na duhet më shumë se dashuria për të funksionuar një marrëdhënie. Të duash dikë tjetër nuk do të thotë domosdoshmërisht se do të jesh më i lumtur dhe më i mirë në zgjidhjen e problemeve të përditshme. Aq më keq se shumë njerëz ndahen përkundër faktit se e duan njëri-tjetrin.

Njerëzit që e duan njëri-tjetrin prirën të ndahen dhe të bëhen sërish bashkë disa herë, përpara se të përfundojnë përfundimisht lidhjen e tyre. Ata ndahen, bëhen përsëri bashkë dhe provojnë përsëri të ndahen. Sidoqoftë, në grahamat e vdekjes së një marrëdhënieje, dashuria bëhet

e dhimbshme. Masat që merrni për ta mbajtur atë gjallë, thjesht, e bëjnë plagën më të madhe.

CILAT JANË ARSYET QË NJERËZIT NDAHEN?

Zgjidhni të jeni në një lidhje me dikë për shumë arsye, si: pasioni, tërheqja, miqësia, bashkëpunimi dhe kimia. Megjithatë, ju mendoni se ka një hendek të gjerë që nuk do të mbyllet, një burim vuajtjeje që nuk do të largohet. Planet tuaja të jetës mund të pengojnë marrëdhënien tuaj perfekte. Për ju, puna juaj është gjithçka. Të gjitha planet tuaja të së ardhmes rrotullohen rreth karrierës suaj.

Partneri juaj, nga ana tjetër, është më i fokusuar në të pasurit fëmijë. Ata nuk janë aq të emocionuar me ambicien tuaj profesionale.

TË DUA, POR NUK TË KUPTOJ!

Të kuptosh dikë do të thotë të vendosësh veten në vendin e tij dhe të lidhesh me realitetin e jashtëm. Kjo, ndoshta, duket themelore dhe thelbë-

sore, por mund të jetë jashtëzakonisht e vështirë të bëhet me një partner romantik.

Ndonjëherë, dashuria nuk di ose nuk dëshiron të kuptojë...

NËNÇMIMI I PARTNERIT

Një tjetër arsye e zakonshme pse çiftet ndahen është se njëri prej partnerëve ndihet i nënvlerësuar. Sepse, kur jeni me dikë për një kohë, filloni t'i merrni gjërat si të mirëqena: Veprimet e tyre, mundi i tyre, gjestet e tyre, virtytet e tyre etj.

PROBLEMET E KOMUNIKIMIT

Komunikimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm në marrëdhënie. Të dish të dëgjosh, të flasësh në mënyrë të sigurt, të dish të mos biesh dakord pa u emocionuar tepër dhe të bësh kompromise, janë gurët e themelit të çdo marrëdhënieje.

Kështu, një arsye tjetër pse njerëzit që e duan njëri-tjetrin ndahen është komunikimi i dobët. Sepse, vetëm dashuria nuk mjafton për ta mbajtur një marrëdhënie.

anaderm

Spitali i specializuar për
Kirurgji Estetike dhe Plastike

**Prof. Dr.
Selahattin Özmen**

**Specialist i Kirurgjisë Estetike dhe
Rikonstruktive**

Kanë mbetur vetëm edhe pak vende
të lira për konsulta dhe operacione
tek **Dr. Selahattin Ozmen**

Shkaku i kërkesave të shumta
rezervimet janë të obliguara!

24 - 25
Mars



**Për rezervime
045 707 744**

Ç'janë këta lot të Merita Halilit?

Merita Halili: "Ajo që më dhemb më shumë është se në SHBA mësoj këngëtarë të këndojnë shqip".

Merita Halili, një nga këngëtalet më të mira shqiptare, e cila prej shumë vitesh jeton në SHBA, shpesh rikthehet në Shqipëri. Ajo, në një emision televiziv, ndër të tjerash, zbuloi se në SHBA jep mësim bashkë me bashkëshortin, Raif Hysenin, për komunitetin shqiptar që jeton e vepron atje.

"Jap mësim kanto për studentët tanë që i kemi në fakultet. Ndërkaq, Raifi u jep mësim orkestrës dhe grupit të ansamblit shqiptar atje, ku edhe kemi hapur një degë të muzikës ballkanike. I mësoj këngëtarët që të këndojnë shqip dhe, pa dyshim, jam edhe mësuese në shkollën fillore", thotë ajo dhe vazhdoi:

"Ndihem shumë krenare që e kam kaluar detin 10 ballë, por ajo që më dhemb më shumë është malli që kam për vendin tim.

Jeta në Amerikë është e vështirë, por ia kam dalë bashkë me bashkëshortin tim, Raifin".



BOOM



*Sa janë reale
çiftet që lidhen
brenda formatit
televiziv
“Big Brother”?*

“VIP Nails & Beauty”

*me punë të shkëlqyer
dhe suksese mahnitëse
në Zvicër dhe Kosovë*

*Cilët
këngëtarë tanë
kanë pasur
probleme
me ankth?*

*A ishte
Stresi më i
merituari?*



“VIP Nails & Beauty”

me punë të shkëlqyer dhe suksese mahnitëse në Zvicër dhe Kosovë



“VIP Nails & Beauty” prej vitesh është shndërruar në adresën më të preferuar të femrave që duan të duken bukur e të trajtuara në mënyrën më të mirë e më profesionale të mundshme.

Lendita Frroki, e njohur si profesioniste e dëshmuar e fushës së bukurisë dhe estetikës, ia ka dalë që përmes punës së pandalshme, ta shndërrojë emrin e biznesit dhe emrin personal në një brend të padiskutueshëm. “VIP Nails & Beauty” tashmë thuhet me të njëjtin koncept si salloni qendror në Aragau të Zvicrës, gjendet edhe në Gjakovë, ku klientela e kënaqur i ka dhënë vullë suksesit.

KUR KLIENTELA E KËNAQUR TË BËN TË NJOHUR...

“VIP Nails & Beauty” në Gjakovë është një opsion i ri për femrat që të marrin shërbime me cilësi evropiane dhe me staf të mirëtrajnuar në fushën e estetikës.

Në sallonin në Zvicër janë tejet të kërkuara trajtimet profesionale dhe zbukurimi i fytyrës me metodat Microneedling, Aqua Facial, Dermafazion, Radiorefequenz etj.

Pastaj, bërja e thonjeve të duarve e të këmbëve, vetullat (vimpern) qerpikët, depilimi me laser, zbardhja e dhëmbëve etj.

Siç mësojmë, të gjitha klientet dalin të kënaqura nga salloni në fjalë, meqë marrin saktësisht atë që duan, sepse në “VIP Nails & Beauty” punojnë me produkte liderë në tregun ndërkombëtar.

Ndërkohë, në pikën në Gjakovë ofrohen shërbimet:

- depilimi me laser
- manikyr dhe pedikyr
- tretmanë të ndryshëm kozmetikë
- depilim me dyll
- mikrogjilpërim etj.

Për shtojcën tonë “Boom” Lendita potencon se të gjitha shërbimet ofrohen me profesionalizëm, përkushtim, delikatësi dhe korrektësi nga stafi i saj. “Punën e bëj me shumë përkushtim, korrektësi dhe, pa dyshim, pasion e dashuri, sepse pa qenë të gjitha këto bashkë, vështirë mund të arrihet suksesi.

E, për të arritur në këtë nivel të punës, gjatë gjithë karrierës sime është dashur të kryej shkollë, dhjetëra kurse, seminare të ndryshme etj. Jam angazhuar gjatë gjithë kohës për avancim më të mirë në këtë fushë”.

Adresa në Zvicër:

Aragau, Zentralstrasse 32 5610 Wohlen.

Adresa në Gjakovë:

Rruga “Tirana”, në transit



Cilët këngëtarë tanë kanë pasur probleme me ankth?

Shëndeti mendor është i rëndësishëm për të gjithë dhe nuk duhet të mbahet sekret, por të shfaqet, sepse vetëm atëherë tejkalohet më lehtë.



Alban Ramosaj



Dafina Zeqiri



Fifi



Semi Jaupaj

Depresioni, ankthi dhe stresi janë simptoma që përjetojnë, duke dhënë reaksione të ndryshme. Depresioni shfaqet te të gjithë njerëzit, pa dallim moshe, gjinie dhe profesioni. Prekë të gjitha shtresat e shoqërisë, duke u lënë pasoja një kohë të gjatë.

Ankthi është përgjigja kryesore e trupit ndaj rrezikut. Kur jemi të shqetësuar, trupi përmblyet me hormone për të përgatitur organet e ndryshme, në mënyrë për të shmangur ose përballuar rrezikun. Stresi është një përgjigje fiziologjike normale

ndaj një situatë anormale. Kjo i mundëson trupit tonë të përshtatet me bashkësinë e ngjarjeve pozitive dhe negative që përjetojmë, si lindja, martesë, humbja e punësimit, pamundësi për të arritur qëllimet etj. Sidoqoftë, shëndeti mendor nuk dallon nga njerëzit e thjeshtë dhe ata të famshëm, por disa prej tyre nuk kanë dëshirë ta shprehin dhe më e keqja kanë frikë edhe ta trajtojnë dhe mjekojnë, nga frika se mos po cilësohen me probleme psikike.

TË NJOHURIT TANË QË KANË PASUR APO KANË PROBLEME MENDORE

Shumica e të njohurve tanë problemet mendore i mbajnë për vete dhe nuk i shprehin. Por, ka edhe nga ata që i bëjnë publike. E, disa nga ta janë: Dafina Zeqiri, Semi Jaupaj, Alban Ramosaj, Filloreta Raçi etj.

Dafina Zeqiri në vitin 2021 publikoi një postim në "Twitter" duke shkruar, ndër të tjerash: "Nuk është turp me shkua te psikologu. Nuk është turp me fol për ankth dhe depresion".

Viti 2018 ka qenë i vështirë edhe për këngëtarin dhe tekst-shkruesin Alban Ramosaj. Ai, në një intervistë, në pyetjen "A ke ankth?", u përgjigj:

"Po, kam herë pas herë. Është e rëndësishme për ta kuptuar se nuk është asgjë më tepër se një reaksion që ndodh në trurin tuaj dhe asgjë s'do t'u ndodhë".

Ndërkaq, Semi Jaupaj për ankthin u shpreh sa ishte pjesë në "Big

Brother VIP Albania 1".

Rrëfimi i Semit për këtë periudhë të vështirë ishte i mbushur me emocione.

"Jam person që dua t'i përballoj gjërat vetë dhe e kam shumë të vështirë të kërkoj ndihmë. Më kishin kapur disa herë kriza paniku, por refuzoja kategorikisht që të pija ilaçe. Një ditë në makinë me Bojkenin nuk po merrja dot frymë dhe i kërkoja të shkonim në spital. Atë ditë kam provuar ilaç për herë të parë.

Edhe mami im ka vuajtur nga kjo gjë dhe nuk doja ta shqetësoja", thotë Semi e përletur.

E Fifi, sa i përket periudhës së ankthit, shprehet se ajo situatë i ka lënë pasoja shumë kohë.

Këngëtarja, ndër të tjerash, shkruan: "Nuk përballoj emocione të forta as negative e as pozitive, e prapë jam e lumtur se mund të dashuroj pa kontroll".

Fifi tani duket se e ka tejkaluar këtë periudhë dhe po e shijon pritjen e ëmbël të fëmijës që po e pret.

Edona Villasaliu-Bajoku

A ishte Stresi më i merituari?



Të premten që shkoi përfundoi Spektakli “Big Brother VIP Kosova” dhe fitues u shpall Arkimed Lushaj (Stresi).

Reperi nga Shqipëria, i cili ka qëndruar 103 ditë në shtëpinë e famshme “Big Brother VIP Kosova”, ka fituar edicionin e parë të këtij “reality show” në Kosovë. Në fund të garës mbetën katër konkurrentë finalistë: Juli Nura, Vedat Bajrami, Artan Thaçi dhe Mbresa Hajrullahu. Në mbrëmjen finale banorët e parë që u eliminuan nga gara ishin: Mbresa Hajrullahu dhe Artan Tha-

çi. E, pas tyre e la garën e madhe modelja nga Drenica, Juli Nura. Ndërkaq, dy finalistët e fundit, Vedati dhe Stresi, u shprehën të lumtur për pjesëmarrjen në një spektakël të tillë dhe për eksperiencën që kaluan brenda, por Vedati nuk arriti të marrë çmimin e madh, sepse Stresi fitoi çmimin e madh prej 200 mijë eurosh, ku nga 10 mijë euro shkojnë për secilin finalist.

Sa janë reale çiftet që lidhen brenda formatit televiziv “Big Brother”?

Formati televiziv “Big Brother” është transmetuar për herë të parë në vitin 1999 në Holandë, ndërsa më vonë është shfaqur ndërkombëtarisht. Zanafilla e formatit “Big Brother” është frymëzim nga romani i Xhorxh Orvellit, me titull “Nineteen Eighty Four”. Spektakli realizohet në mbikëqyrje të vazhdueshme nga kamerat 24 orë.

Ky format televiziv sivjet ka nisur të transmetohet edhe në vendin tonë, i cili me t’u paralajmëruar se do të fillojë, nisi ta shtojë kuriozitetin e publikut, duke u nisur nga pyetja se kush mund të jenë banorët, cila është data e saktë e fillimit të shout televiziv e të tjera. Edhe pse të mbyllur në një shtëpi, situatat dhe momentet e ndryshme,



me të cilat banorët përfshihen aty, ndodhin edhe në jetën reale.

SI NDODH KRIJIMI I LIDHJEVE BRENDA “BIG BROTHER”?

Krijimi i lidhjeve brenda spektaklit “Big Brother” është temë që ngjallë kuriozitet - se si mund të ndodhë një gjë e tillë brenda mureve, madje pa e menduar se si do të vazhdojë

lidhja jashtë.

E çuditshmja është se një raport intim mes dy personave krijohet brenda, pa marrë asnjë informacion nga jashtë, se si ka qenë jeta e tij para hyrjes në reality-show. Dhe, kur e analizojmë lidhjen e çifteve në reality show, shtrihen shumë pyetje se si mund të funksionojë brenda.

Qysh nga fillimi i transmetimit të “Big Brother” në Shqipëri dhe “Big Brother VIP Kosova”, janë krijuar shumë çifte, e disa prej tyre janë duke e jetuar jetën së bashku. Me këtë rast përmendim rastin e moderatores, Einxhel Shkira dhe Dj Dagz, të cilët kanë nisur lidhjen në “Big Brother” dhe pa kaluar shumë kohë lidhja e tyre mori përmasa serioze, sa që çifti u bën prindër të një djali.

Po ashtu, kemi rastin e DJ PM me Sarën, çifti i cili po vazhdon ta shijojë lidhjen edhe pas daljes nga “Big Brother”.

E, çift tjetër që u njohë brenda formatit televiziv, e që po e vazhdojnë njohjen jashtë, janë moderatori Andi Artani me modelen Gresa Hoti, e edhe blogerja Vivien Thano me reperin Getinjo.

Megjithatë, ka edhe çifte që kanë përfunduar edhe jo mirë. Rasti i tillë ka ndodhur në “Big Brother VIP Albania 1”, me moderatorin





Donald Veshaj e këngëtares Beatrix Ramosaj.

Ç'THOTË FISNIK JUNIKU, ISH-BANOR NË "BIG BROTHER KOSOVA"?

Dhe, për të analizuar më në thelb lidhjet mes çifteve, kemi biseduar me ish-banorin e "Big Brother Kosova", Fisnik Juniku, për të kuptuar më shumë rreth çifteve të "Big Brother" se sa janë të vërteta, sa janë të besueshme e të tjera. Banori i "Big Brother VIP Kosova", Fisnik Juniku, u shpreh se do kishte krijuar një lidhje brenda formatit për faktin se, sipas tipit dhe shijes së tij, nuk e sheh diçka të pamundur, megjithëse sa ka qenë brenda nuk i ka pëlqyer askush.

FJALA E SOCIOLOGUT LEUTRIM SAHITI

E, sa i përket asaj se a e lejon etika njerëzore lidhjen ndërmjet çifteve në reality-show, sociologu Leutrim Sahiti thotë se krijimi i raporteve ndërmjet individëve në këto formate televizive, duke përfshirë edhe raportet mes çifteve, janë pjesë e lirive dhe të drejtave të njeriut. Por, lidhja mes dy personave

brenda këtij formati, sigurisht, dalton nga lidhjet që bëhen në jetën reale. Sahiti thotë se, së pari, duhet të sqarojmë se formatet e tilla televizive janë eksperimente sociale, ku individët pranojnë me vetëdëshirë të marrin pjesë në një eksperiment të tillë, i cili ka skenar të shkruar dhe ku njerëzit brenda tyre vihen në situata loje dhe ku shpërfaqin personalitetin dhe identitetin e tyre. Në këto formate njerëzit brenda tyre tregojnë histori që u kanë ndodhur më herët, por në raste të caktuara edhe manipulojnë me situata të ndryshme nga e kaluara e tyre, për të fituar mbështetje dhe popullaritet.

Vlen të përmendim se sjelljet e individët brenda këtyre formateve ndikohen në masë të madhe nga lojërat dhe rrethi në të cilin jetojnë, andaj edhe ata bëjnë vepra që në jetën e tyre reale vështirë do t'i bënin.

Me fjalë të tjera, në formate të tilla gjërat gjykohen në mënyrë subjektive, të ndikuara nga lojërat dhe rrethi dhe arsyeja e individëve në raste të caktuara pushon së funksionuari.

Këtu, sigurisht, hyjnë edhe lidhjet mes partnerëve, të cilat janë të ndikuara më shumë nga gjendja

emocionale e individëve brenda, sesa arsyeja e tyre e vërtetë.

Dhe, duke ditur se çdo ditë po shkojmë drejt modernizimit, qëllimi i formateve të tilla, në parim, është rritja e shikueshmërisë së produksionit dhe përfitimi i tyre ekonomik nga shou që krijohet brenda në format.

Sidoqoftë, në shoqërinë tonë formatet e tilla janë mjaft tërheqëse, sepse nuk jemi mësuar t'i shohim më herët dhe ende jemi të ndikuar nga to.

Mirëpo, në një të ardhme jo të largët këto formate do të humbin relevanten e tyre dhe interesimi për t'u bërë pjesë e tyre apo për t'i ndjekur do të bie dukshëm.

Andaj, lidhjet e tilla, sigurisht, do të gjykohen nga jashtë, qoftë në familje, qoftë në rrethin shoqëror dhe çiftet në raste të caktuara mund edhe të bullizohen e stigmatizohen, shkaku se si shoqëri kemi pasur sistem tjetër të vlerave, i cili, nëse e krahasojmë me këtë formë të lidhjes së partnerëve, është diametralisht i kundërt.

Dhe, për fund, të krijosh një lidhje, sigurisht, është shumë sfiduese për secilin njeri, si në jetën reale ashtu edhe brenda një formati televiziv.

Natyra Salihaj

Pse aktori Fatmir Spahiu kurrë nuk u bë kryetar?

“Oki”, “Buft” dhe shumë role të tjera nuk harrohen asnjëherë, të cilat me mjeshtërinë më të madhe artistike i realizoi aktori shumë i dashur për publikun tonë, Fatmir Spahiu.

Në këtë shkrim nuk do të bëjmë fjalë për projektet e tij artistike, sepse ato janë shumë dhe me vlerë të pakontestueshme.

Por, do të fokusohemi te jeta e tij private, të cilën ai e shpalosi ditë më parë në “Intervistën e Buzhalës” në televizion.

Është me rëndësi të thuhet se në vitet 90, kur pothuajse të gjithë shqiptarët ishin në një krah, në LDK, qoftë si aktivist, qoftë si përkrahës të lëvizjes, “Oki” tha se si i ri më shumë i pëlqente dhe e përkrahte ish-të burgosurin politik Adem Demaçin, sepse, sipas tij, ai kishte një vizion tjetër, paksa më agresiv.

Ishte adhurues i politikës së Demaçit një kohë të gjatë, por vetëm një herë e kishte takuar në Prekaz, me të cilin tha se nuk kishte, madje, as fotografi bashkë.

Mirëpo, zhvillimet e mëtejme, e sidomos periudha e luftës në vitet ‘98-99 e vunë në siklet dhe e pa se me luftë vështirë dilet në krye.

Andaj, tash, pas shumë vjetësh, përkrah haptazi moton e të madhit Ibrahim Rugova: “Kosova shtet i pavarur dhe i hapur ndaj Shqipërisë dhe Serbisë” dhe e ndjen veten në njëfarë mënyre sikur është penduar që nuk ka qenë përkrahës i politikës së Rugovës që nga fillimi i Lëvizjes, të cilën ai e


udhëhoqi.

Këtë e arsyeton edhe me faktin se të gjitha bisedat që tash po bëhen nga SHBA-të dhe Bashkësia Evropiane, në qendër kanë Kosovën shtet i pavarur dhe i hapur ndaj Shqipërisë dhe Serbisë, moto kjo e ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. Por, t’i kthehemi titullit të këtij shkrimi. “Oki” gjatë shkollimit në gjimnaz kishte pasur dëshirë të ishte edhe në organet e rinisë udhëheqëse të shkollës dhe kishte arritur të bëhej nënkryetar i rinisë shkollore, por jo edhe kryetar, e që, siç thotë paksa me humor, nuk arriti kurrë të bëhej kryetar.

I.



allure®
B E A U T Y



BEFORE.

MARIANA KONDI



AFTER.

**E vetmja klinike ku mund te kryesh
lifting pa kirurgji!**

E bukur
përjetë!

Jam më budalla se budallai!

Ka kohë që nuk kam dal të shëtis në qytet, që, zakonisht, bëhet në sheshin qendror të Prishtinës. Dy herë brenda një dite u gjenda në shesh, por me dy pamje. Para dite me veshje të zakonshme, e pas dite, siç thoshim dikur, me rroba “ganc” e me kravatë...



Teksa shkova para dite me veturë te Fakulteti Filologjik, u ofrova te rampa dhe e luta rojën ta ngritë rampën, që të hyja me veturë në oborrin e fakultetit.

“Kam nevojë të shkoj në Bibliotekën Kombëtare”, i thashë.

“E ke huq, sepse biblioteka është poshtë!”, ma ktheu dhe as që deshi të bisedonim më shumë.

Dhe, pa një e pa dy u largova me veturë, sepse s’doja të krijoja skena të padëshirueshme.

E, kur shkova pas dite po në të njëjtin vend me veturë, roja u afrua afër dhe më pyeti se ku shkoja.

I thashë:

“A bën ta parkoj veturën në oborr të fakultetit se kam nevojë të shkoj në Bibliotekën Kombëtare?”.

“E ke huq, sepse biblioteka e ka hyrjen pas fakultetit!”, ma ktheu.

“E di, o burrë, por këtu e kam më lehtë ta parkoj veturën!”, ia ktheva.

Por, ai, pasi më shikoi paksa gjatë, i ra në sy

veshja ime “ganc” dhe kravata.

Dhe, fill e ngriti rampën...

MEDIET PUNOJNË VEÇ ME INTERES!

Hy në amfiteatrin ku, zakonisht, promovohen libra të rinj. Aty mbahej një promovim i librave të një publicisti të njohur.

Por, nuk shoh askënd as me aparat fotografik e as me kamerë, e që do ishte në interes të medieeve ta prezantonin promovimin, sepse ashtu bëhej dikur.

I ofrohem moderatorit dhe e pyes:

“Si është e mundur që asnjë medium të mos jetë i pranishëm?!”.

“Paske rrëshqitur!”, ma ktheu ai dhe vazhdoi: “Më as hoxha në minare nuk hip pa para, e lëre më mediet të vijnë e të xhirojnë!”.

Eh, thashë me vete, pse e pyeta e dola më budalla se budallai!

Kam mbetur jashtë rrjedhave të jetës...

S. M.



Dy botime me vlerë të veçantë



LIBRI "FERRI DREJT VARREZËS MASIVE SHTJELLON KRIMET SERBE NË KOSOVË:

Si u prenë shqiptarët në sharra circulare?

Ditë më parë dolën nga shtypi dy libra të rinj nga Shtëpia Botuese "Faik Konica: "Ferri drejt varrezës masive" dhe "Ura e Lotëve", të gazetarit dhe publicistit Safet Krivaca.

Si u dogjën krushjanët të gjallë në stallë?
Si u gjymtuan kufomat e shqiptarëve?
Si u planifikua dhe ekzekutua kolona e Korishës?
Si pësoi popullata shqiptare në Drenicë, në Malishevë e Rahovec?
Si u qepën pa anestezion pacientët shqiptarë në spitalet e Prishtinës?
Si u dhunuan femrat në Kosovë?

**NDËRKAQ, NË LIBRIN
"URA E LOTËVE",
VEÇ TË TJERASH,
MUND TË LEXONI:**

Vrasjet institucionale të shqiptarëve në ish- Jugosllavi;
Shqiptarët e CIA-s që deshën përmbyshjen e komunizmit të Enver Hoxhës;
Si u mbajtën peng shqiptarët e Kosovës 12 vjet në Serbi?
Si luftuan shqiptarët në armatën kroate?
Kush dhe sa pagoi për gjetjen e Ukshin Hotit?
Si u nda Gorozhupi dhe si u shkëmbyen pengjet mbi "Urën e Lotëve" në Vermicë?
Si dhe rrëfimet e dëshmitarëve që sollën për herë të parë në dritë realitetet e përgjakshme, e të tjera...

Natën e martesës i rashë pishman që u martova!

Jam burrë i martuar. Por, në natën e martesës i rashë pishman që u martova! Më vinte inati që i harxhova një shumë të madhe parash për dasmë, se po atë natë e kisha lëshuar gruan menjëherë!

Kur e kam marrë gruan i ka pasur 80 kg, e tash ka zbritur në 60 kg. Me të jam njohur 2 vjet e gjysmë para se me u martuar. U njohëm në rrjetet sociale. Mezi ia pata marrë numrin, sepse ishte prej atyre femrave që i fol e s'ta kthen.

Dhe, unë, budallai, thashë hajt t'i shkruaj... E kam pasur qëllimin qysh me e zënë, me u kënaq me të dhe me e lënë.

Pas shumë përpjekjesh e binda që të takoheshim në qytet, buzë Lumbardhit, e të pinim kafe.

E, teksa pinim kafe më tregoi për të kaluarën e saj. Më tha: "I kam pasur dy frajera, me të cilët nuk kam pasur marrëdhënie seksuale, veç jemi puthur.

Madje, njëri më gënjeu shumë, duke më dhënë premtime se do të martohemi, por e dija se meshkujt këqyrin me të shti në dorë e pastaj..."

MË PREKU NË SHPIRT HISTORIA E SAJ...

Dhe, pasi më tregoi për të kaluarën e saj e më tha se ende është e virgjër, mu shtua dëshira që ta kem, që të jem i pari në jetën e saj.

Por, nuk doja edhe të hyja në gjynah me të...

I lamë vetes hapësirë me menduar për hapat e mëtejme... Kështu, gjatë asaj kohe u takuam disa herë, por jo me krijuar lidhje pa qenë të vendosur mirë.

Dhe, pasi u takuam 3-4 herë, u dashurova në të shumë.

I thashë: "Jam i gatshëm me u martuar!"

Më tha: "Ani, mos u ngut! Me rëndësi është se po pëlqehemi!"

E, pas këtyre fjalëve u puthëm. U puthëm me loqën e zemrës. Andaj, ajo puthje bëri që të nesërmen me pa durim e prita takimin me të...

Kështu, takim pas takimi, arritëm të jemi bashkë rrafsh dy vjet e gjysmë. Por, gjatë asaj kohe kurrë nuk kam insistuar në marrëdhënie seksuale. Kisha qejf që ajo gjë të ndodhte vetëm në natën e martesës...

PSE GRUAJA IME ISHTE E FTOHTË NË NATËN E MARTESËS?

E, në natën e martesës shoh se ishte e ftohtë dhe thashë - më paska tradhtuar gjatë asaj kohe...

Por, ajo më tha troç:

"Burri jem, në jetën time tri herë kam

pasur marrëdhënie me frajerin e parë dhe pata mbetur shtatzënë!

Dhe, kur e kuptoi që isha shtatzënë ma ktheu shpinën dhe u nda prej meje...

Pastaj, kur pashë se u largua prej meje vendosa të abortoj dhe e bëra një gjë të tillë, sepse nuk doja ta koritja familjen, t'ua qitja faqen e zezë...

E, ty nuk të kam treguar, sepse nuk doja të të lëndoja.

Por, ja, erdhi dita të të tregojal!"

Në çast mendja më humbi dhe thashë me vete: Hajt-hajt, çka do të shkretëtojë tjetër?!

Në atë moment çdo gjë m'u errësua para syve dhe ia dhashë një shuplakë të fortë dhe e rrëzoja në shtrat...

E, të nesërmen, në ditën e grave, ja kanë lyer me pudër fytyrën, sepse ishte bërë krejt mavi.

Andaj, nga ajo ditë, edhe pse kanë kaluar katër vjet, ende s'po mund ta harroj atë natë, natë e cila ma prishi ëndrrën e jetës sime, rahatinë time bashkëshortore...

Kam menduar me shkuar te ndonjë hoxhë dhe të ma bëj një hajmali, e cila do m'i largoj nga mendja mendimet e këqija, por po më vjen inati se si do i tregoj që gruaja nuk ma ka thënë të vërtetën para martesës...

Veliu, Pejë

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de



Ku ndodhet këngëtarja, mbesa e Nexhmije Pagarushës?

Bleta Mulliqi është e lindur në Prishtinë, por me familje që moti jeton në Zvicër.

Ishte shumë e re kur në Prishtinë nisi të ndiqte shkollën për piano, që e ka vazhduar më pas në Zvicër.

"Në Zvicër isha e ngarkuar me shkollën, me vallëzimin dhe me sportin, ndaj muzika më mbeti paksa anash", pat thënë Bleta kur para shumë vitesh bëme bisedë me të.

E, duke qenë mbesë e Nexhmije Pagarushës dhe e kompozitorit Rexho Mulliqi, Bletës iu zgjua pasioni për këngën.

Startoi në Festivalin "Shou fest 2003", me këngë të Ilir Beranit, e cila u pëlqye nga publiku.

"Ideja e realizimit këngës ishte e Ilir Beranit dhe e gjyshes", pat thënë ajo.

ÇKA KA PARAQITUR NEXHMIJE PAGARUSHA NË JETËN E SAJ?

"Isha e re, andaj nuk e kam përjetuar shkëlqimin që e ka pasur gjyshja ime dikur si këngëtare.

E kam bërë një këngë në gjuhën shqipe dhe njëherë për një herë mendoj të këndoje vetëm shqip, por me kohë mund të bashkëpunojë edhe më të huaj.

Më pëlqen muzika A&B dhe e dëgjoj me ëndje këtë lloj muzike.

Por, përveç këngës, në shpirt më fle edhe vallëzimi. Është një ëndërr e fëmijërisë sime. Megjithatë, vallëzimi më ka ndihmuar shumë edhe në skenë, sepse këngëtari duhet, veç të tjerash, të dijë edhe të vallëzojë dhe të ndjehet lirshëm para publikut", pat theksuar ajo në vitin 2003, kur edhe bëme bisedë me të.

Sidoqoftë, stili i saj duket unik, shndrit

me vokalin e saj. Ishte pjesëmarrëse edhe në "Ethet e së premtes mbrëma 2001-2002", ku arriti deri në gjysmë-finale.

Ishte pjesëmarrëse e shumë festivaleve: "Polifest", "Videofest", "Nota Fest" në Maqedoni dhe ka fituar mjaft çmime.

KËNGË KUSHTUAR GJYSHES, NEXHMIJE PAGARUSHËS

Në vitin 2003 publikoi videoklipin "Se kam dit", këngë e cila i dedikohet gjyshes së saj, Nexhmije Pagarushës, me tekst të Ilir Beranit e me orkestrim të Enis Preshevës.

Në vitin 2008 publikoi videoklipin "Dance Avec Moi", këngë e cila fitoi një çmim në Festivalin

"Mikrofoni i Artë 2008".

Përndryshe, ajo tash është 43 vjeçe dhe ende jeton në Zvicër. Atje i ka kryer studimet në UBT.

Summer Loading



S'kam mend, kam fëmijë me 3 grá!

Kam fëmijë me tri gra. Gruaja e tretë, kur natën vonë u ktheva në banesë, m'tha: "Jo, zotni, sillu rrugëve deri në sabah se më s'ke banesë këtu!"

Jam 47-vjeçar, por jeta nuk më shkoi mbarë aspak. Kur isha i ri familja më fejuan për femrën që e kishim fqinje. Por, edhe pse kundërshtova u martova. Por, aspak i lumtur nuk isha. Pas dy vjetësh gruaja lindi vajzë. Ishte e shëndoshë si molla. Por, një vit më vonë u ndamë, sepse, siç thashë, martesë ishte bërë pa dëshirën time. Kështu, gruaja e mori vajzën dhe u kthye te familja e saj dhe më vonë u martua, kurse vajzën ia dha tezës së saj që ta rriste...

SI U MARTOVA NË KURBET ME TURKE?

Një vit më vonë, duke mos gjetur rehati shpirtërore shkova në kurbet, në Gjermani. Atje u njoha me një të huaj me prejardhje turke dhe pas gjatë muajsh bashkë u

martuam.

Në fillim çdo gjë ishte mirë, por unë isha shumë i parahatshëm dhe më shumë e kaloja kohën nëpër lokale të natës sesa në banesë me gruan, ani pse ndër vite u bëmë me dy fëmijë.

Por, fati im i mjerë dhe pas 12 vjetësh martesë u ndamë dhe fëmija, natyrisht, i takonin nënës, sepse ligjet e Gjermanisë ishin ashtu.

Kështu, një kohë mbeta vetëm dhe pas orarit të punës silllesha, siç thuhet në popull, si terzia pa penj...

AS NË MARTESËN E TRETË NUK U REHATOVA!

Ndërkohë, lidhje pas lidhjes, rashë në kontakt me një femër nga Kosova, e cila më parë kishte qenë e martuar, por ishte ndarë nga burri.

I thashë se nuk mund ta marrë menjëherë në Gjermani, sepse turkja nuk dëshironte ta prishte kurorën, andaj më duhej ta bindja gjyqtarin që ta bënte një gjë të tillë. Por, vëllai i saj, meqë jetonte në Gjermani, ia dërgoi garancinë dhe e mori vizën pa kurrfarë problemi dhe filluam të jetojmë bashkë.

Pas 3 muajsh mbet shtatzënë dhe lindi djalë. U gëzua ajo, por edhe unë. Por, unë, budallai i vjetër, prapë iu ktheva lokale të natës dhe kur vija në banesë, kah mesnata, gruan e gjeja zgjuar, duke më pritur...

Mirëpo, një natë kupa e saj ishte mbushur

dhe e gjeta duke qarë. Më tha: "Boll më, dua të ndahem, se me ty nuk po u jetuaka!"

I thashë do të ndryshoj. I premtova se do të jem njeri tjetër, por e kisha humbur besimin te ajo dhe s'kishte forcë ta bindja... Më tha: "Nuk e ke gjetur femrën që luan me të dhe nga mëngjesi që vjen më nuk dua të të shoh në banesë, përndryshe të paraqes në polici!"

Andaj, kur pashë se veç ishte mbushur kupa e saj, të nesërmen mora teshat e mia në valixhe dhe u vendosa në hotelin më të afër, derisa të gjeja banesë.

S'KANË FAJ FEMRAT, ZOTI NUK MË KA DHËNË MEND!

Dhe, pas një muaji, kur shkova ta shihja tim bir se a ishte rritur bile sado pak, ajo ma hapi derën dhe më tha: "Banesën jam duke e paguar vetë dhe më nuk ke vend këtu!"

Kështu, edhe pas shumë përpjekjesh që ta bindja, u ktheva kah kisha ardhur, sepse, thënë troç, s'kishte faj, meqë budallaqet i bëja vetë.

Vetë isha shkaktari i ndarjes...

Por, ç'të bësh?! Kështu po të sprovuaka jeta...

Andaj, edhe pse ende jam në moshë të re, siç thashë 47 vjeç, i lashë pas tri martesë dhe 3 palë fëmijë në duar të huaja, se Zoti nuk më ka dhënë mend boll!

Kurtishi, Gjermani

SUANITA

High End Luxury



SUANITA High End Luxury ofron produkie ekskluzive dhe unike nga të gjitha markat luksoze !

Parimi ynë mund të përkufizohet si:

MË E MIRA PËR MË PAK: Gjithmonë ofrojmë cilësinë më të mirë për çmimin më të mirë.

CILËSI E GARANTUAR: Ofrojmë veiem produkie të cilësisë më të lartë, premium në çdo detaj (imazh i klasës së parë !)

Shikoni arrijtë e fundit :

📍 Ferid Curri Prishtinë

📷 suanita_highendluxury

🌐 www.suanitashop.com



Pse gruaja më konsideron budalla?!

Bëra-ç'bëra dhe më së keqi më shkon puna me grua. Ajo që i ha të gjitha, në fund të fundit, është gruaja...

Rashë natën të flija. U rrotullova sa në një krah në tjetrin, por gjumi nuk më zinte. Gruaja më tha:

"Çka nuk po rehatohesh?"

"Jam duke i menduar disa tema që t'i shkruaj", ia ktheva.

"A për këtë nuk po fle, a?!", ma ktheu ajo.

"Po".

Ajo e ndezi dritën dhe më tha: Shkruaj...

Në çast m'u kujtua vaji i një lypësi, në sheshin qendror të Prishtinës. Dhe, fillova t'i shënoj ca vargje.

Ndërkohë, gruaja u shtri të flinte, por kur unë e lashë fletoren ajo u zgjua dhe tha: "Lexo çka shkrove!".

Unë nisa të recitoja, si njeri që isha mbushur vrer nga misionet dhe debatet, e edhe nga pamjet në shesh.

E, kur mbarova recitim, gruaja më tha: "Vazhdo me këto vargje:

O Zot, jepi mend këtij budallai!

Që kur lypësit flenë

Ky të mos rri zgjuar!"

"Grua, ke ide edhe për poezi!", i thashë.

E, ajo ma ktheu:

"Të flesh me ty e të mos kesh ide, kjo nuk është e mundur! Më në fund, a e lehtësove shpirtin?!".

"Po. Uh, sa jam lehtësuar, grua! Nuk e merr me mend dot sa i lehtë jam bërë. Po fluturoj nga gëzimi që edhe ti po mësohesh të shkruash, e, kështu, më motivon më shumë", ia ktheva përgjigjen.

BUDALLAI NË POEZINË E GRUAS JAM UNË!

Kur u zgjova në mëngjes i lexova vargjet e gruas. Vargje me logjikë. Ndër të tjerash, kuptova se personazhi "budalai" në poezinë e gruas isha unë.

Dhe, për të mos e paraqitur veten si personazh, i thashë gruas se do ia tregoj një ngjarje për Nastradinin: Kishte dëgjuar Nastradini se ish sëmurë prefekti i Ak-Shehirit.

I merr disa mollë në bahçe për t'ia dhënë.

E, pasi troket në derë, prefekti ia hapë derën.

"Si je?", e pyeti Nastradini.

"Keq, o Nastradin! Dy probleme i kisha, por njërin e hoqa. Tash më ka mbetur vetëm një. Dhëmbët më dhembnin dhe i hoqa, por tash veshët më dhembnin! Nuk di ku të gjej një mjek që më bën zgjidhje?" i thotë prefekti hoxhës.

Hoxha ia kthen:

"Ashtu sikur i hoqe dhëmbët, zoti prefekt, gjeje dikë të t'i shkulë edhe veshët, sepse shumë ke dëgjuar me ta e nuk e ke bërë asnjë të mirë!"

"Demek, edhe mua ashtu!", më tha gruaja.

"Jo, grua, tamam puna të t'i shkulë veshët!

Por, edhe këto po tingëllojnë si vargje", ia ktheva, sepse kishim kohë mjaft, meqë gjumi nuk na zinte.

S.

Revolucion në dobësim

Qendra e dobësimit “Shkenda Dubova” është ndër bizneset e vetme kosovare me qendra në dy kontinente të botës.

Përmes rezultateve konkrete e shumë të suksesshme të klientëve, dhe për shkak efektivitetit të kësaj teknologjie, qendra arriti zgjerimin edhe jashtë vendit. Qendrat e dobësimit Shkenda Dubova tani operojnë në: **Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë, Norvegji, Angli e Amerikë.**

Programi për humbje peshe është i testuar, verifikuar dhe certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare.



Në qendrat e dobësimit ofrohet shërbim i veçantë që ndodhë në disa procese, përmes aparaturave të teknologjisë më të re në këtë fushë. Përmes shërbimit të dobësimit, ofrohet djegia e kalorive, nxitja e metabolizmit, shkrirja e masës dhjamore dhe trajtimi i thellë te saj.

Humb
peshe

Detoksifikohu



Relaksohu

Balanco
shëndetin

Nëse nuk e keni ditur...

Pse këngët për ndarjet janë shumë të dëgjueshme?

Një nga këngët më ikonike për fundin e një lidhjeje është “I Will Always Love You”. Ajo u këndua nga Vitni Hjuston dhe u popularizua në filmin “The Bodyguard”.

Kënga pat sukses të jashtëzakonshëm dhe arriti të qëndronte në vendin e parë në “Billboard Hot 100” 14 javë në vitin 1992.

Është interesante se kjo këngë u shkrua në vitin 1973 nga Dolly Parton.

Duket se kemi arritur në një epokë në të cilën ndarjet, të paktën në fushën muzikore, nuk përjetojnë më me dëshpërim dhe melankoli. Në fakt, sot, fundi i dashurisë ia lë vendin

fuqizimit. Ndonjëherë, dashuria romantike dekonspirohet dhe promovohet ideja se nuk keni nevojë për një partner për të qenë të lumtur.

APELI I KËNGËVE TË NDARJES

Këngët për ndarjet zgjojnë ndjenjat më të forta të njerëzimit. Nuk ka rëndësi nëse teksti u bën të derdhni lot. Përtej rrethanave që shkaktojnë zemër-thyerjen në këngë, qëndrojnë emocionet.

Sidoqoftë, të gjithë kemi përjetuar situata të ngjashme. Ndonjëherë dashuria zbehet pa shpjegim. Ndonjëherë jeni mashtuar mizorisht dhe tradhtuar. Ndaj, janë mijëra këngë për të gjitha llojet e ndarjeve dhe dëgjimi i teksteve që të kujtojnë historitë e tua ngjallë ndjeshmëri.

Por, jo vetëm kaq. Është ngushëlluese të dish se njerëzit e tjerë kanë kaluar nëpër humnera të ngjashme emocionale.

Dhe, papritur është dikush që ta shprehë me fjalë pikërisht atë që ndiheni. Kjo është e mahnitshme dhe e këndshme, në të njëjtën kohë.

DËGJIMI I KËNGËVE PËR THYERJEN E ZEMRËS JANË SHËRIM

Një studim i bërë në Londër thekson se këngët mund të ndërmjetësojnë disa pro-

cese fiziologjike që përmirësojnë mirëqenien tonë fizike dhe psikologjike. Ato na lejojnë t'i rishikojmë historitë, t'i shfryjmë emocionet tona dhe ta kompozojmë veten.

JU LEJOJNË TË PËRBALLEN ME TRAZIRAT EMOCIONALE

Dëgjimi i këngëve për ndarjet u lejon t'i ripërqendroni ndjenjat tuaja për t'i kuptuar më mirë ato.

Ato mund t'u ndihmojnë të kuptoni arsyen e zemërimit tuaj dhe ta menaxhoni atë.

Ato u ndihmojnë, gjithashtu, të toleroni trishtimin, pasi e dini që të tjerët kanë kaluar të njëjtën gjë. Emocionet kondensohen në tekste dhe jeni në gjendje t'i çlironi ndjenjat tuaja për të ecur përpara.

ATO TË MËSOJNË SE DO TË MBIJETOSH!

Sot këngët për ndarjet janë fuqizuese.

Ato të mësojnë se, pavarësisht dhimbjes që ndjen, nuk do të vdesësh nga thyerja e zemrës, do të mbijetosh.

Për më tepër, ju mund të mësoni nga përvoja dhe ta shihni veten në një mënyrë më të ndritshme, më të fortë dhe më të pavarur.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Cilët njerëz janë shumë të zgjuar?

Ekziston një besim i lashtë që beson se shenjat e zodiakut ndikojnë në personalitetin dhe aftësitë e një personi. Ndër këto aftësi, një nga më të dëshiruara është inteligjenca. E, cilat janë shenjat e zodiakut që ka shumë të ngjarë të jenë të zgjuar?

VIRGJËRESHA

Virgjëresha shpesh konsiderohet shenja më e zgjuar e zodiakut. Ata janë

jashtëzakonisht të organizuar, analitikë dhe të saktë në kuptimin e tyre të botës. Këto tipare i bëjnë ata zgjidhës të shkëlqyer problemesh dhe shumë pragmatikë.

PESHORJA

Peshorja është një tjetër shenjë zodiake e njohur për inteligjencën e saj. Ata janë jashtëzakonisht të menduar dhe kureshtarë dhe shpesh kanë një kapacitet të madh për analizë. Gjithashtu, janë shumë të ekuilibruar dhe dinë si t'i peshojnë me saktësi dhe në mënyrë racionale opsionet.

AKREPI

Akrepi është i njohur për thellësinë e tij intelektuale. Ata janë shumë të vëmendshëm ndaj hollësive dhe mund të analizojnë një situatë nga shumë kënde

të ndryshme. Ata janë, gjithashtu, shumë intuitivë dhe mund t'i lexojnë shumë mirë njerëzit dhe situatat.

SHIGJETARI

Shigjetari është i njohur të jetë shumë kurioz dhe aventuresk. Ata shpesh janë të apasionuar pas njohurive dhe dashurisë për të eksploruar ide dhe koncepte të reja. Ata janë, gjithashtu, shumë filozofikë dhe të dashur për të bërë pyetje që sfidojnë normën.

UJORI

Ujori është i njohur për kreativitetin dhe origjinalitetin e tij. Shpesh janë shumë novatorë dhe mund të mendojnë jashtë kutisë. Ato janë, gjithashtu, shumë analitikë dhe mund të gjejnë zgjidhje krijuese për problemet më komplekse

CIMA

Construction

We bring the future
to the present...

Kompleksi Dardania, Prizren

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pas mëkateve dua të nisi jetë të re...

Përshëndetje zonjë e nderuar! Jam 21-vjeçare, kam një hall të madh. Jam shtatzënë në muajin e shtyrë të shtatzënisë, ku nuk mund të bëhet aborti dhe po ndihem keq prej familjes.

Shtatzënia ka ndodhur falë bashkëjetesës me një person, që prisja të shkoj çdo gjë si më së miri me të... Por, jam zhgënjyer shumë dhe jam e dëshpëruar nga jeta.

Megjithatë, po pres të filloj një jetë të re dhe t'i harroj gjërat e ndodhura.

Jam e penduar dhe dua që Zoti t'mi fal mëkatet që i kam bërë.

Të lutem, si do të jetë jeta ime?

"Fa."

Përgjigje

Nëse mendon për historinë e këtij problemi, është vonë dhe reagimi i vonuar ka bërë

që gjërat të vështirësohen deri te pendimi.

Shtatzënia me njeriun e tillë të ka krijuar probleme në familje, megjithatë gjërat janë aty ku janë dhe nuk ja vlen të mendosh shumë se si ka ndodhur çdo gjë.

Fëmija është fëmijë, pa marrë parasysh se kush është babai i tij.

Ajo që është me rëndësi tash - mos kalo në depresion, sepse do bëhesh nënë dhe do të të fillojnë preokupime të reja, të cilat do të të qojnë me vëmendje kah fëmija.

Në këtë mënyrë, jeta jote do të ndryshojë shumë, sepse gjërat do t'i shikosh nga këndi i nënës, pa marrë parasysh nëse do ta mbash apo do ta japësh fëmijën.

Megjithatë, do të vijnë ditët kur do të qeshesh dhe kjo jetë stresi do të të kalojë dhe do të ndihesh stabile në jetë, sepse njeriu mësohet me çdo gjë. E, në fund të fundit, të jesh nënë është kënaqësi.

Ka përfunduar gjithçka, por nuk po mundem pa të!

Jam burrë i martuar. Në rini e kam dashur një vajzë, e cila tani është bërë zonjë. Koha ka shkuar, por unë nuk mundem ta harrojë, apo, të paktën, nuk mund ta përballoj pa folur me të... Familja më kanë penguar të jem me të, megjithatë e dua shumë dhe e di se ende e dashuroj...

"Pa shifër"

Përgjigje:

Nuk duhet të jetoni me ëndrrat rinore! Koha ka kaluar dhe nuk është në dobinë tuaj sa i përket asaj që, gjithashtu, ka familje.

Me kohë është dashur të bëhet çdo gjë, andaj ka ekzistuar dukuria e ikjes së vajzave kur i kanë marrë për gra meshkujt që nuk kanë mundur pa ato.

E, ti nuk e ke shfrytëzuar të drejtën tënde për të krijuar jetën me atë që e ke dashur, ndaj tash nuk ia vlen të shkaktosh më shumë probleme për një gjë që nuk u takon më.

Dhe, nëse vazhdon kështu, shoh se mund të zbulohet i tërë problemi dhe hyni në rrugë pa dalje.

Andaj, kthehu në jetën tënde, sepse është vonë ta kthesh kohën e shkuar!

Ç'qëllim ka ish-i dashuri im?

Jam një vajzë 27-vjeçare, jetoj në rrethin e Ferizajt. Kam pasur një të dashur, me të cilin kemi qenë së bashku 7 vjet, por ai u martua. Ndërkohë, ai shkoi jashtë dhe i ka bërë letrat nga gruaja e tij. Megjithatë, mu ka lajmëruar përsëri dhe direkt më ka ofruar martesë, duke më premtuar besnikëri. Jam pa tekst! Jam e humbur prej kur ma ka thënë këtë gjë dhe nuk di t'i besoj a jo... Çka më këshillon?

"E humbura"

Përgjigje:

Kam mendim negativ sa i përket ribashkimit tuaj me martesë.

Këshilla ime është ta gjesh fatin e ri, sepse mund të ndodhin shumë gjëra të pakëndshme nëse ju lidheni përsëri. E para, ribashkimi juaj me martesë do të qonte në ndarjen e tij nga gruaja, e cila ia ka bërë letrat për qëndrim; E dyta, është problem, pastaj, t'i mbetën letrat atij. E treta, çrregullimi ndër-familjar mund të prodhojë krejt situata të reja... Andaj, kërkoje fatin e ri dhe harroje atë person, sepse në kohën e duhur nuk të ka

bërë zgjidhje, andaj nuk e ke të sigurt se as tani që do të të bëjë zgjidhje fatlume...

Pse nuk më duan njerëzit?

Zonja magjistare, të shkruaj nga një vend i vogël evropian. Jam 38-vjeçare, nënë e dy fëmijëve. Me burrë jam ndarë para dy vjetësh dhe vazhdoj të punoj e t'i rrisë fëmijët vetë. Por, kam një hall: Të gjithë ikin prej meje! Nuk më ofrohet askush, edhe pse unë nuk u bëj keq... Kjo po më dhemb në shpirt, sepse nuk po kam me kë të shpreh asnjë brengë... Ç'të bëj që ta rifitoj rrethin tim ku ka edhe shqiptarë shumë?

"Nëna"

Përgjigje:

Ti jeton në një vend të vogël, ku çdo gjë merret vesh shpejt. Ke pasur lidhje me një person, banor i atjeshëm dhe kanë dalë fjalë për ty... Andaj, kjo ka bërë që rrethi të të shmanget, por edhe familja e burrit po bën propagandë të madhe që të të largohen njerëzit prej teje. Sugjerimi im është të sillesh mirë me njerëzit kudo që je dhe të jesh nënë e edukatore e mirë, e pastaj gjërat do të shihen vetvetiu dhe rrethi yt do të rikthehet përsëri...

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Si e sheh të ardhmen time pranë burrit?

Përsëendetje, jam zonjë 33-vjeçare, jetoj në Prishtinë. Një kohë kam jetuar jashtë Kosovës, por nuk kam mundur të bëj jetë atje, andaj jam kthyer në vendlindje. Jam martuar në vitin 2019. Dua të di si do ta kem jetën time dhe, nëse ka mundësi, t'më thoni diç për të kaluarën time se ku kam gabuar që nuk më shkoi mirë jeta në kurbet?

"Milja"

Përgjigje:

Nuk të shoh pranë burrit me të cilin jeton. Sepse, je martuar me të pa e shëruar plagën nga ndarja me burrin me të cilin ke jetuar në Gjermani. Prandaj, gabimi qëndron mu aty se, të paktën, edhe dy vjet nuk është dashur të kishit bërë martesë. Sepse, të martohesh me një burrë, duke vuajtur për tjetrin me të cilin ke jetuar, është krim dhe nuk të bën të lumtur as ty e as burrin. Andaj, së shpejti do të ndaheni...



SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend

SHERWOOD
exclusive kemer

SHERWOOD
exclusive lara

SHERWOOD
Dreams Resort

TUI BLUE
Belek

SHERWOOD
Premio Hotel

GREENWOOD
Kemer Resort

GREENWOOD
Suites Resort

 [sherwoodresorts](https://www.instagram.com/sherwoodresorts)  [greenwoodhotels](https://www.instagram.com/greenwoodhotels)

www.sherwoodhotels.com.tr www.greenwoodhotels.com.tr